



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 190/1 Prot.

Tiranë, më 28 .01 .2021

V E N D I M

Nr. 14, Datë 28 / 01 / 2021

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 156, datë 22.12.2020, e bërë nga L.K kundër “Dreams Bar¹”, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “identitetit gjinor”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues informon se: *“Në datë 07.10.2020, rreth orës 15.07, së bashku me dy persona të tjerë kanë qenë të ulur tek lokali. Kanë pritur rreth 30 minuta dhe kamarieri nuk i ka shërbyer, dhe kur ka dashur të bëjë porosinë, kamarieri i ka thënë se, “nuk i shërbejmë transave”, dhe më pas kanë debatuar me njëri tjetrin. Pas këtij momenti ka pyetur banakieren se, për ç’farë arsye nuk i shërbehet kafe? Banakierja i është përgjigjur se nuk do pronari. Më pas ka telefonuar policinë në numrin, 129. Ankuesi shprehet se, duke qenë figurë publike është ndjerë i ofenduar pasi në lokal kishte klientë të cilët kishin ndjekur situatën dhe ishin tallur”*.

Referuar, Raportit të Shërbimit të mbajtur nga oficerët e patrullës së policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 3, në datë 07.10.2020, shkruhet se: *“.....patrulla ka marrë kontakt me personelin e*

¹ NUIS: L92315008L, Emri subjektit: D.H.

lokalit, shtetasen N.H (banakiere), e cila i ka sqaruar se nuk ka asnjë konflikt, por nuk mund tu shërbente sepse sipas saj ankoheshin klientët e tjerë se do të largoheshin nga lokali nëse ishin të pranishëm këta shtetas”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe falje publike nga ana e subjektit kundër të cilit është bërë ankesa.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 156, datë 22.12.2020 të shtetasit L.K u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Me shkresën nr. 1806/1, datë 28.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion nga Dreams Bar, lidhur me pretendimin e subjektit ankues si dhe ka kërkuar nga subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Me shkresën datë 06.01.2021, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, punonjësja e Bar Dreams, N.H, kërkonte ndjesë publike lidhur me ngjarjen e ndodhur në lokal në datë 07.10.2020.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, referuar nenit 33/9 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*, në datë 18.01.2021, ftoi palët për të marrë pjesë në një seancë pajtimi.

Seanca e pajtimit u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, L.K dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses së Dreams Bar, N.H. Gjatë seancës së pajtimit N.H në emër të stafit të lokalit kërkoi ndjesë për rastin në fjalë duke deklaruar se ankuesi do jetë i mirëpritur në lokalin Bar Dreams. Ankuesi u shpreh se ka kërkuar ndjesë publike nga ana e lokalit, e cila u realizua nga ana e Komisionerit dhe se pranon ndjesën e subjektit, Bar Dreams.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Sipas informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit, u konstatua që, në datë 07.10.2020, ankuesi i shoqëruar nga dy persona të tjerë, janë ulur në lokalin Bar Dreams, por nga personeli i lokalit është refuzuar për ti shërbyer, pasi i përkasin komunitetit LGBTI.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Identiteti gjinor, është shkak për të cilin ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me identitetin gjinor dhe orientimin seksual.

Bazuar në nenin 7 të Ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Kjo sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*.

Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për ti mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Mosdiskriminimi është e drejtë kushtetuese e sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në nenin 18 Kushtetuta parashikon *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë ndër parimet dhe të drejtat më themelore të legjisllacionit që mbron të drejtat e njeriut, pasi ato janë të ndërlidhura me dinjitetin njerëzor dhe janë guri i themelit për të gjitha të drejtat e njeriut. Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës në Rekomandimin CM/Rec (2010)5 të Komitetit të Ministrave *“Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor³”*, ka vënë në dukje se të drejtat e njeriut janë universale dhe zbatohen për të gjithë individët, dhe i rekomandon shteteve anëtare se duhet të sigurojnë miratimin e masave legjisllative dhe masave të tjera si dhe zbatimin e tyre efektiv për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, për të garantuar pjesëmarrjen e barabartë të personave të komunitetit LGBTI në shoqëri dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë në baza të barabarta me të tjerët, duhet të eliminohen edhe pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet apo stereotipet negative që për fat të keq konstatohet se përdoren ndaj personave të komunitetit LGBTI.

Personeli i Bar Dreams, duke refuzuar për ti ofruar shërbimin ankuesit, e ka vendosur atë në pozita denigruese duke e cënuar në dinjitetin e tij. Komisioneri vlerëson se të gjithë subjektet tregëtare si bare, restorante, etj, duhet të ofrojnë shërbime me të njëjtën cilësi dhe pa paragjykime për të gjithë klientët pavarësisht nga identiteti gjinor apo orientimi seksual i tyre.

³ <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804d3ee8>

Për sa më lart, në kushtet kur subjekti ndaj të cilit ka nisur procedura hetimore ka reaguar në mënyrë të shpejtë duke kërkuar ndjesë publike, si me shkrim ashtu dhe në seancën e pajtimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata është rregulluar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është paraqitur ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 33, pikat 9 e 10, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, nenin 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 156, datë 22.12.2020, paraqitur nga L.K kundër Bar Dreams, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA